

VENDIM
Nr. 156, datë 13.3.2019

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.658, DATË 8.10.2014, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA NDËRTIMI I SEGMENTIT RRUGOR “ZGJERIMI I RRUGËS SË ELBASANIT” (FAKULTETI FILOLOGJIK–UNAZA E MADHE E TIRANËS)

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr. 658, datë 8.10.2014, të Këshillit të Ministrave, bëhen ndryshimet, si më poshtë vijon:

1. Në tabelën bashkëlidhur vendimit hiqen pasuritë me nr. 23/11, nr. 23/13, nr. 23/12 dhe nr. 23/8, të cilave u përkasin, respektivisht, numrat rendorë 31, 32, 33 e 34, të ndodhura në zonën kadastrale 3266, pasqyruar në tabelën bashkëlidhur këtij vendimi.

2. Në pikat 3 dhe 4, vlera e përgjithshme e shpronësimit të pronarëve ndryshon nga 154 394 299.8 (njëqind e pesëdhjetë e katër milionë e treqind e nëntëdhjetë e katër mijë e dyqind e nëntëdhjetë e nëntë pikë tetë) lekë në 150 563 038.8 (njëqind e pesëdhjetë milionë e pesëqind e gjashtëdhjetë e tre mijë e tridhjetë e tetë pikë tetë) lekë.

3. Në pikën 5, vlerës së shpenzimeve procedurale i shtohet vlera 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë, e cila do të përballohet nga Autoriteti Rrugor Shqiptar.

4. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Autoriteti Rrugor Shqiptar, Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Tiranë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

LISTA EMËRORE E PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, TË CILËT PREKEN NGA DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN E KËSHILLIT TË MINISTRAVE NR. 658, DATË 8.10.2014, “PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA NDËRTIMI I SEGMENTIT RRUGOR “ZGJERIMI I RRUGËS SË ELBASANIT” (FAKULTETI FILOLOGJIK–UNAZA E MADHE E TIRANËS)

Nr.	Nr. rendor në VKM-në nr. 658/2014	Emri	Atësi	Mbiemri	Z.K	Nr. i pas.	Lloji i pasurisë	ISHTE			BËHET	Shënime
								Sip. e shpronësuar në VKM-në 658/2014 (m²)	Çmimi (lekë/m²)	Vlera në VKM-në 658/2014 (lekë)	Vlera	
1	31	Lulezim	Jusuf	Brahja	3266	23/11	Truall	229	3283	751,807	0	Konfirmim ZVRPP
2	32	Skender	Jusuf	Brahja	3266	23/13	Truall	229	3283	751,807	0	Konfirmim ZVRPP
3	33	Majlinda	Jusuf	Brahja	3266	23/12	Truall	99	3283	325,017	0	Konfirmim ZVRPP
4	34	Hetem	Nuredin	Brahja	3266	23/8	Truall	610	3283	2,002,630	0	Konfirmim ZVRPP
		Halit	Nuredin	Brahja								
Vlera totale										3,831,261	0	

Shënime.

Nga ndryshimi i projektit të zbatimit janë lënë jashtë vijës së shpronësimit katër pasuritë përkatësisht me nr. 23/11, nr. 23/13, nr. 23/12 dhe nr. 23/8, të ndodhura në zonën kadastrale 3266, të cilat kanë qenë të përfshira në shpronësim në VKM nr. 658, datë 8.10.2014. Meqenëse këto katër pasuri janë lënë jashtë vijës së shpronësimit do të hiqen nga VKM nr. 658, datë 8.10.2014, me vlerë totale të shpronësimit 3 831 261 lekë.

